



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 1 (827699)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 Janar 2021

Olta Xhaçka, mesazh urimi për Forcat e Armatosura



Forcat e Armatosura janë kthyer në një mesazh shprese dhe besimi

Tërmeti dhe më pas pandemia treguan edhe njëherë jo vetëm kapacitetet e Forcave të Armatosura për të përmbushur detyrën e tyre, por njëherësh edhe dimensionin e tyre human duke qenë kudo ku ka nevojë. Përmes një videomesazhi për festat e fundvitit, më 31 dhjetor 2020, ministrja e Mbrojtjes Olta Xha-

çka u shpreh mirënjohjen mijëra burrave dhe grave që mbajnë veshur me krenari uniformën. Xhaçka thekson se efektivët e FA ia kanë dalë të bëjnë punë shumë të mira, në një vit me shumë sfida. "2020 ishte për FA një vit sfidash, të cilat bashkërisht i kemi kaluar me sukses. Ia kemi dalë të..."

» faqe 2

PRESIDENTI ILIR META, DEKRETON

Niko Peleshi dekretohet në krye të Ministrisë së Mbrojtjes



» faqe 3

95 - Vjetori i Forcës Detare

Lockheed Martin do të përmirësojë kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare

Xhaçka: Pas pajisjes së anijeve të klasit Iliria me topa 20mm, do të vijojmë me disa projekte të tjera modernizuese, siç janë pajisja e anijeve me sisteme komunikimi, që do të na lehtësojnë komunikimin me aleatët

» faqe 3



Me rastin e festave të fundvitit

Një "Musical" dhe dhurata për fëmijët e ushtarakëve

Pandemia nuk i ka ndaluar fëmijët e ushtarakëve të presin bukur festat e fundvitit. Ashtu siç është tashmë traditë edhe këtë vit Sektori i Aktiviteteve, pranë Qendrës, Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, ka sjellë në ditët e fundit të muajit dhjetor 2020 një koncert për bashkëmohatarët e tyre. Koncerti u organizua pranë Muzeut të Forcave të Armatosura ku ishin të pranishëm shumë fëmijë...



» faqe 5

"Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi"

Shpallet fituesi në pozicionin "Financier", ja detyrat e tij!

Në kuadrin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire for Emergency management -355", me bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", Ministria e Mbrojtjes ftoi kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin si më poshtë: FINANCIER për zbatimin...

» faqe 6



ANALIZË Dezinformimi në Ballkanin Perëndimor dhe siguria rajonale

Përgatiti: MSC MIMOZA GOLIKJA

» faqe 8-9

MESAZH I SHSHP GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ

FARSH kontribuon për paqen në kuadër të misioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së

» faqe 4

HISTORIA E FORCAVE DETARE

Nga viti 1925 deri tek misioni "Sea Guardian" në detin Egje

» faqe 4

OLTA XHAÇKA, MESAZH URIMI PËR FORCAT E ARMATOSURA

Forcat e Armatosura janë kthyer në një mesazh shprese dhe besimi

Dua t'i falenderoj nga zemra këta djem dhe vajza që i shërbejnë Shqipërisë brenda dhe jashtë kufijve të saj, për gjithçka kanë bërë në 2020 dhe dua t'u uroj më të mirën për 2021

Tërmeti dhe më pas pandemia treguan edhe njëherë jo vetëm kapacitetet e Forcave të Armatosura për të përbushur detyrën e tyre, por njëherësh edhe dimensionin e tyre human duke qenë kudo ku ka nevojë. Përmes një videomesazhi për festat e fundvitit, më 31 dhjetor 2020, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka u shpreh mirënjohjen mijëra burrave dhe grave që mbajnë veshur me krenari uniformën.

Xhaçka thekson se efektivet e FA ia kanë dalë të bëjnë punë shumë të mira, në një vit me shumë sfida. "2020 ishte për FA një vit sfidash, të cilat bashkërisht i kemi kaluar me sukses. Ia kemi dalë të realizojmë shumë punë të mira, për ta bërë FA më moderne, më profesioniste, më pranë standardeve të një ushtrie të NATO, më të aftë për të garantuar sigurinë, jetën shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve shqiptarë.

S'ka qenë e lehtë deri më sot e s'ka për të qenë e lehtë prej këtej e tutje. Por nuk na trembin vështirësitë apo sfidat. Na mjafton që qytetarët sot e vlerësojnë FA si kurrë më parë. Këta djem dhe vajza që i shërbejnë Shqipërisë brenda dhe jashtë kufijve të saj, dua t'i falenderoj nga zemra për gjithçka kanë bërë në 2020 dhe dua t'u uroj më të mirën për 2021, sepse me punën e tyre janë kthyer në një mesazh shprese dhe besimi, në një mesazh optimizmi për të gjithë. Faleminderit për shërbimin dhe qoftë 2021 një vit më i mbarë për gjithsecilin nga ju dhe familjet tuaja!", shprehet në mesazhin e saj për të gjithë efektivet e FA ministrja Olta Xhaçka.



Forcat e Armatosura sot janë në shërbim 24 orë në 7 ditë të javës dhe falë vendimeve të kësaj qeverie ka një trajtim më të mirë financiar dhe është e pajisur me mjete njësoj si kolegët e tyre të vendeve të NATO-s. Po ashtu investimet në infrastrukturë në këto

vite dhe prania në misionet në shumë vende të botës e bëjnë FA eksportues të sigurisë. Një arritje tjetër, është edhe kthimi i Akademisë së Forcave të Armatosura në institucionin e vetëm të arsimit të lartë, i akredituar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Urime për 200 efektive të inkuadruar të misionet e NATO-s dhe BE

FA përfaqësohet me misione paqeruajtëse në Kosovë, Afganistan, Letoni, Sudanin e Jugut dhe Bosnje-Hercegovinë

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka zhvilluar një bisedë online me përfaqësues më të lartë në NATO dhe misionet paqeruajtëse në Kosovë, Afganistan, Letoni, Sudanin e Jugut dhe Bosnje - Hercegovinë. Veç urimit për festat e fundvitit, ministrja e Mbrojtjes është interesuar edhe për shëndetin e efektiveve dhe familjarëve të tyre, në këto kohë të vështira pandemie.

"Tek unë do të keni gjithmonë, përveçse një mike shumë të mirë edhe avokaten tuaj më të fortë", u shpreh gjatë bisedës ministrja Xhaçka, ndërsa shprehu mirënjohjen për kontributin e dhënë nga çdo efektiv i FA, brenda dhe jashtë vendit. Në takimin online, ku kanë marrë pjesë drejtues të forcave,



shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, ka siguruar vijimin e vëmendjes për efektivet dhe familjarët e tyre.

Aktualisht FA përfaqësohet me 200 efektive në kuadër të misioneve të NATO-s dhe BE-së në disa vende të botës.

Medalja "Joint Service Commendation Medal"

Gjeneral Tod D. Wolters, nderon Kapter Olsi Canin

Efektivët e Forcave të Armatosura spikasin me përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre në strukturat më të rëndësishme të NATO-s. Kapter Olsi Cani u nderua me medaljen "Joint Service Commendation Medal" nga komandanti Suprem i Fuqive Aleate në Evropë Supreme Headquarters Allied Powers Europe (SHAPE), gjeneral Tod D. Wolters, për shërbimin dhe bashkëpunimin e tij të shquar me Forcat e Armatosura të SHBA.



PRESIDENTI ILIR META, DEKRETON:

Niko Peleshi dekretohet në krye të Ministrisë së Mbrojtjes

Më datë 31 dhjetor 2020, në ditën e fundit të vitit që sapo u mbyll, Presidenti i Republikës, njëkosisht Komandant i Forcave të Armatosura ka dekretuar me Nr. Dekreti 11892, emërimin e z.Niko Peleshi, Ministër i Mbrojtjes. Dekretimi është mbështetur në Dekretin Nr. 6655 prot. datë 29.12.2020. Zoti Niko Peleshi do të zëvendësojë në këtë post të rëndësishëm zonjën Olta Xhaçka e cila është emëruar Ministre për Europën dhe Punët e Jashtme me dekret Nr.11891 datë 31.12.2020. Dekretimet e mësipërme kanë ardhur pas vendimit të Kryeministrit Edi Rama për ndryshime në qeveri. Pas miratimit nga parlamenti të këtyre ndryshimeve, më datë 4 janar 2021, pritet që z.Niko Peleshi të ulet në karrigen e Ministrit të Mbrojtjes.

Niko Peleshi është një njohës i mirë i pushtetit ekzekutiv, jo vetëm së në disa vite ka drejtuar Bashkinë Korçë, por edhe për faktin se ai në vitin 2013 u zgjodh Zëvendëskryeministër në qeverinë Rama I dhe në vitin 2017 në qeverinë Rama II mori postin e Ministrit të Bujqësisë, të cilin e mbajti vetëm një vit, deri në dhjetor 2018. Niko Peleshi ka lindur në Korçë, me 11 nëntor 1970. Ka kryer studimet e larta për Inxhinieri Elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës me rezultate të shkëlqyera duke marrë titullin Inxhinier Elektronik. Në vitin 1989 ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme "Raqi Qirinxi" në Korçë, me Medalje të Artë. Ai është i martuar dhe ka tre fëmijë Aleksian, Stivin dhe Johanin.



95 - Vjetori i Forcës Detare

Lockheed Martin do të përmirësojë kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare

Xhaçka: Pas pajisjes së anijeve të klasit Iliria me topa 20mm, do të vijojmë me disa projekte të tjera modernizuese, siç janë pajisja e anijeve me sisteme komunikimi, që do të na lehtësojnë komunikimin me aleatët

Më rastin 95-Vjetorit të Krijimit të Forcës Detare në molin nr. 4 të Portit të Durrësit u kremtua më 24 dhjetor 2020, ceremonia e rastit. Në këtë ceremoni të rëndësishme morën pjesë ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj, Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të FA, përfaqësues të institucioneve detare, të administratës detare, Portit Durrës, QNOD, veteranë të Flotës dhe personel detar i Forcës Detare.

Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia i uroi detarëve 95 - Vjetorin duke theksuar se "... është privilegj dhe kënaqësi e veçantë t'ju drejtohem sot me rastin e 95 - Vjetorit të Krijimit të Forcës Detare. Traditat detare të popullit tonë janë po aq të lashta sa dhe vetë historia e tij. Efektivat që ndodhen sot para jush dhe detarët tanë janë pasardhës të denjë të traditës detare, që vjen e gjallë prej lashtësisë. Historia moderne e Forcës Detare shqiptare daton më 25 Dhjetor 1925, kur një grup marinarësh nën drejtimin e Ahmet Kapidanit valëvitën flamurin shqiptar në ujërat tona territoriale. Anijet "Shqiponja" dhe "Skënderbeg" dhanë sinjalin e parë të patrullimit të Forcës Detare, në emër të ruajtjes së kufirit të shtetit shqiptar.

Në përfundim më lejoni që në këtë 95-Vjetor të krijimit të Forcës Detare të falënderoj të gjithë ata detarë nën oficerë dhe oficerë, që ndër vite me sakrificën, guximin dhe heroizmin e tyre duke u përballur me sfidat e detit, gjatë lundrimeve në mot të qetë e të trazuar, ditën dhe natën i dhanë jetë Forcës Detare duke e sjellë deri në ditët e sotme. Ata do të jenë gjithmonë burim frymëzimi dhe force për ne. Nga ana tjetër ne kemi përgjegjësinë, që ta çojmë përpara dhe ta zhvillojmë Forcën Detare që trashëguam, me qëllim që të kryejmë me sukses detyrat e shenjta, që na janë ngarkuar."

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, në këtë përvjetor kujtoi një nga performancat më të jashtëzakonshme të FD në Detin Egje, gjatë operacionit "Sea Guardian", duke shpëtuar mbi tremijë jetë njerëzish.

Duke vlerësuar mbështetjen e partnerëve e aleatëve të NATO-s, ministrja e Mbrojtjes tha: "Projekti më i rëndësishëm është kontrata afat-



gjatë e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare me kompaninë amerikane Lockheed Martin, që do të përmirësojë kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare".

"Pas pajisjes së të gjitha anijeve të klasit Iliria me topa 20mm, vitin që vjen, siç diskutuam edhe me gjeneral Xhebexhinë, do të vijojmë me disa projekte të tjera modernizuese,

siç janë pajisja e anijeve me sisteme dhe pajisje komunikimi, që do të na lehtësojnë komunikimin me aleatët", - theksoi ministrja Xhaçka, teksa foli edhe për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së riparimit të anijeve të Forcës Detare duke hapur rrugë projekteve të modernizimit me anije të reja dhe moderne. Forca Detare mban si ditë të formimit të saj 25 Dhjetorin e vitit 1925.



Ja misioni i Forcave Detare

Forca Detare ka për mision sigurimin dhe ruajtjen e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimin i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëpunim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare. Të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t'ju përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues. Të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA-së dhe të NATO-s në drejtimet e kërcënuara. Monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë. Organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA. Të ruajë dhe të mbrojë mjedisin detar për zbatimin e ligjshmërisë në det. Sigurimi i kushteve hidrolundimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH. Të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrijë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve. Të marrë pjesë në përbashkëpunim dhe rreziqeve asimetrike të terrorizmit, krimit të organizuar në bashkëpunim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.



Mesazh i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Gjeneralmajor Bajram Begaj

FARSH kontribuon për paqen në kuadër të misioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së

Mesazh urimi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Gjeneralmajor Bajram Begaj për Krishtlindje dhe Vitin e Ri 2021

Të dashur ushtarë, nënofficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura! Viti 2020 do të mbetet gjatë në kujtesën e çdo personi si në Shqipëri dhe anekënd botës, për shkak të pandemisë të shkaktuar nga COVID -19. Lajme pozitive nga fusha e shkencës, tashmë kanë sjellë shpresë për trajtimin e kësaj sëmundje, gjë e cila kërkon prej nesh durim të shtuar, për të vazhduar kujdesin dhe respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Në retrospektivë, ky fundvit na jep mundësinë për të vlerësuar punën e bërë dhe sukseset e arritura, konsideruar vështirësitë dhe problematikat, që kemi hasur për të vënë në praktikë mësimet e nxjerra, si dhe për të planifikuar e përcaktuar objektivat dhe detyrimet për vitin e ri 2021.

Viti që po lëmë pas ishte një vit i pazakontë dhe tejet i vështirë për të gjithë, megjithatë Forcat e Armatosura përmbushën me sukses misionin dhe detyrat kushtetuese. Forcat e Armatosura, në gjithë veprimtarinë e tyre në mbështetje të institucioneve shtetërore për përballimin e pandemisë, në ndihmë të komunitetit dhe popullsisë së prekur nga fatkeqësitë natyrore e shëndetësore, si dhe në operacionet dhe misionet e NATO-s, dëshmuuan profesionalizëm dhe përkushtim të lartë.

Ushtarakët shqiptarë kanë qenë ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në shtabet, operacionet dhe misionet ndërkombëtare. Gjatë kontakteve me Komandantët e Strukturave të NATO-s, më është shprehur vazhdimisht vlerësimi për performancën e lartë të tyre.

Angazhimi dhe kontributi i Forcave të Armatosura nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara, si dhe ato në kuadër të iniciativave rajonale e koalicioneve ndërkombëtare, e kanë rritur rolin e Shqipërisë si faktor kontribues për paqen dhe sigurinë rajonale e globale.



JU FALEMINDERIT PËR ANGAZHIMIN, KONTRIBUTIN DHE SAKRIFICAT TUAJA DHE TË FAMILJEVE TUAJA NË SHËRBIM TË VENDIT, POPULLIT SHQIPTAR DHE ALEANCËS! NE JEMI KRENARË PËR JU.

Unë jam shpresëplotë që viti 2021 do të jetë një vit suksesi për Forcat e

Armatosura me projekte ambicioze për modernizimin, rritjen e operacionalitetit dhe ndërveprueshmërisë nëpërmjet vijimit të pjesëmarrjes në operacionet dhe stërvitjet e përbashkëta. Gjithashtu, vëmendja do të jetë në rritjen profesionale, edukimin dhe trajnimin e personelit ushtarak, si dhe motivimin e kujdesin për ushtarakët dhe familjarët e tyre.

Forca Tokësore do të jetë e pajisur me sisteme luftarake moderne dhe një grup batalion të ndërveprueshmërisë me forcat e Aleancës, i cili së bashku me njësi të tjera të FA-së do të jetë pjesë e stërvitjes më të madhe të realizuar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë "Defender 21".

Forca jonë Ajrore do të ketë në

përdorim helikopterët e avancuar amerikanë "Black Hawk", sistemin e vëzhgimit ajror dhe një bazë ajrore, sipas standardeve të NATO-s.

Kapacitetet e Forcës Detare do të vijojnë të përmirësohen për të garantuar sovranitetin dhe ligjshmërinë në det si dhe do të sigurojnë mbulimin e hapësirës detare dhe shkëmbimin e situatës me Aleancën.

Akademia e Forcave të Armatosura, me programe të rëndësishme të transformuara dhe përshtatura, sipas kërkesave të ligjit të Arsimit të Lartë, do të edukojë drejtuesit e ardhshëm të FA-së. FARSH do të vijojë të kontribuojë për paqen në kuadër të misioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Ushtarakët tanë do të vijojnë të tregojnë vlerat më të mira duke mbajtur lart flamurin kuq e zi, kudo që të jenë në fushëbetejë (Afganistan, Kosovë, Sudan i Jugut, Letoni, Bosnjë-Hercegovinë), shtabe ndërkombëtare apo rajonet stërvitore. Së fundmi, me rastin e festave të fundvitit shpreh urimet më të mira për gjithë personelin e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre. Një urim të veçantë e përcjell për të gjitha vajzat dhe djemtë, burrat dhe gratë me uniformë, që në prag të ndërrimit të viteve, ndodhen në krye të detyrës, brenda dhe jashtë vendit, të gatshëm për të përballuar sfidat e paqes dhe sigurisë.

GËZUAR KRISHTLINDJET DHE VITIN E RI! SHËNDET DHE SUKSESE NË 2021!

25 Dhjetor 2020

HISTORIA E FORCAVE DETARE

Nga viti 1925 deri tek misioni "Sea Guardian" në detin Egje

Me shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor 1912, u bënë përpjekjet e para për organizimin e FD shqiptare nga qeveria e Ismail Qemalit, por fillimi i Luftës së Parë Botërore e ndërpreu këtë angazhim. Në vitin 1925, organizimi i ushtrisë synoi të bëhej mbi bazën e statusit të Shqipërisë hartuar më 7.3.1925. Mbi bazën e këtij statusi u krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive Ushtarake. Më 25 dhjetor 1925, mbërrijnë nga Italia dy anije 190 tonësh, të cilat u emërtuan me emrat domethënës "Shqipëria" dhe "Skënderbeu". Këto anije u pajisën me efektiva marinarësh duke kryer detyra në interes të luftës kundër kontrabandës në brigjet shqiptare.

Më 1928, u krijua Komanda e Marinës dhe më konkretisht më 24.06.1928, kur u mblodhën rekrutët e parë për këtë armë. Më 1934, u blenë po nga Italia edhe dy anije të tjera të lehta, të cilat u emërtuan "Saranda" dhe "Durrësi". Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore pothuajse u shkatërrua gjithçka nga këto anije. Çlirimi i Shqipërisë e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme me pothuajse të gjitha anijet e mbytura në portet e bregdetit shqiptar. Në prill 1945, u krijua Kantieri Detar-Durrës për riparimin e varkave ekzistuese, nxjerrjen e anijeve të mbytura gjatë luftës dhe përgatitjen e tyre për qëllime ushtarake. Më 15 gusht 1945, u bë përfundimi i hedhjes në ujë të dy motoskafeve trofe, me numër MS-10 dhe MS-12. Këto motoskafe u armatosën me mitraloz të lehtë dhe filluan patrullimin për ruajtjen e ujërave bregdetare në Vlorë e Sarandë. Në këtë periudhë u punua me një vizion të qartë për zhvillimin dhe perspektivën e Forcave Detare, duke shfrytëzuar edhe konjunkturën politike të kohës. Kështu mund të përmendim vitet '53-'54, që shënuan fillimin e një etape të re zhvillimi të FD me pajisjen e tyre me silurhedhëse e më vonë me minaheqëse, gjuajtës detar dhe anije ndihmuese të llojeve të ndryshme. Më 14 shkurt 1954, u krijua Skuadrilja e Katrave Silurues me vendbazim në ishullin e Sazanit, kjo shënon edhe fillimin e një



stadi të ri zhvillimi të FD. Zhvillimi e modernizimi i flotës filloi me ritme të shpejta, sidomos pas vitit 1957. Më 21 shtator 1958, filloi aktivitetin një nga njësitë më speciale e më të rëndësishme të FD shqiptare, Njësia e Nëndetëseve, në përbërje të së cilës ishin 4 nëndetëse të prodhuara në ish-Bashkimin Sovjetik.

Në gusht të vitit 1962, u hap Shkolla e Marinës në Vlorë e cila pas viteve 1990 është mbyllur. Mbas viteve '90, për FD shtrohej detyra e ristrukturimit, rikonceptimit të reparteve të saj për një integritet të natyreshëm me strukturat e NATO-s. U zhvilluan me sukses mjaft stërvitje të përbashkëta, si "SAREX-1", "SAREX-2",

"MAREX-1", "MAREX-2", etj. Vlen për t'u përmendur në këtë proces ringritje, ndihma e partnerëve tanë perëndimorë si: SHBA, Italia, Turqia, Greqia, Gjermania, etj.. Në mars të vitit 1998, me ndihmën e qeverisë së SHBA-së, FD u pajisën me 5 morovedeta, të cilat u bënë protagonistë të operacioneve SAR në vitet e ardhshme.

Më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit dolën jashtë strukturave luftarake të FD, 4 nëndetëse të saj, pas një veprimtarie 40-vjeçare. Në vitin 2002, me kontributin e qeverisë italiane pas miratimit të ligjit të Rojës Bregdetare shqiptare, nr. 8875 datë 4 prill 2002. FD u pajisën dhe me 6 motovedeta nga Italia, të cilat së bashku me anijet amerikane u futën në strukturat e Rojës Bregdetare. Mbas një pune njëvjeçare, në muajin nëntor 2008, u zhvilluan provat finale për marrjen në dorëzim të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit Detar (SIVHD), të instaluar nga specialistët e kompanisë "Lockheed Martin". Pas 3 vitesh dhe rreth 13 mijë orëve patrullim në detin Egje, Forca Detare ka përfunduar në dhjetor 2019, kontributin e saj në misionin e NATO-s, "Sea Guardian" në detin Egje. Gjatë 3 viteve në këtë mision, ekuipazhet dhe anijet shqiptare kanë realizuar 178 operacione, duke shpëtuar ose parandaluar rreth 3500 persona, mes të cilëve 120 gra, 220 fëmijë, 38 prej të cilave foshnja. Në misionin "Sea Guardian", shërbyen 14 kontingjente të përbërë nga 294 detarë, në bordin e 3 anije të Forcës Detare, "Oriku", "Butrinti" dhe "Lissus".

Me rastin e festave të fundvitit

Një "Musical" dhe dhurata për fëmijët e ushtarakëve

Fëmijët kanë sjellë një atmosferë të gëzueshme në këto ditë të vështira për të gjithë botën, me shpresën se një vit më i mirë na pret në 2021

Pandemia nuk i ka ndalur fëmijët e ushtarakëve të presin bukur festat e fundvitit. Ashtu siç është tashmë traditë edhe këtë vit Sektori i Aktiviteteve, pranë Qendrës, Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, ka sjellë në ditët e fundit të muajit dhjetor 2020 një koncert për bashkëmoshatarët e tyre. Koncerti u organizua pranë Muzeut të Forcave të Armatosura ku ishin të pranishëm shumë fëmijë të ushtarakëve, prindër, Drejtorja Qëndrës, Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, znj. Mirela Roshi, nën kujdesin e të cilës u zhvillua ky aktivitet etj.

Nën drejtimin e specialistit të sektorit të aktiviteteve, regjizorit Saimir Braho, fëmijët e ushtarakëve zhvilluan një "Musical" pranë ambientit të Muzeut të FA. Përmes vargjeve, tingujve e kërcënimit, fëmijët kanë sjellë një atmosferë të gëzueshme në këto ditë të vështira për të gjithë botën, me shpresën se një vit më i mirë na pret në 2021.

Ndërkohë në ambientet e Komandës Mbështetëse, nën kujdesin e zëvendësministrit të Mbrojtjes, Petro Koçi, u zhvillua një aktivitet me rastin e festave të fundvitit me fëmijët e ushtarakëve, që shërbejnë në Komandën Mbështetëse.

Të pranishëm në këtë aktivitet festiv ishin zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, ushtarakë të Komandës dhe nënrepartëve vartëse së bashku me fëmijët e tyre.

Komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, uroi dhe falënderoi të gjithë



fëmijët pjesëmarrës si dhe familjarët "Gëzuar festat e fundvitit!".

Zëvendësministri Koçi e konsideroi këtë aktivitet, si një rast më shumë për të ndarë jo vetëm urimet për një vit të mbarë, me suksese e shëndet për të gjithë, por edhe për të reflektuar për ngjarjet e këtij viti të vështirë, që po lëmë pas.

"Në këtë kohë të vështirë pandemie ju uroj në radhë të parë shëndet të mirë, lumturi, harmoni në familjet tuaja dhe qoftë një vit i mbarë!". Përpara shpërndarjes së dhuratave, fëmijët pjesëmarrës zhvilluan edhe një program artistik me këngë e recitime.



PËRGJIGJA NDAJ KORONAVIRUSIT

NATO dorëzon 60 grupe të ventilimit për Shqipërinë

Në 28 dhjetor 2020, Ministria e Mbrojtjes mori 60 grupe të konsumit të ventilimit të dhuruar nga Fondi i Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike të NATO-s.

Ky donacion u koordinua nga Qendra Koordinuese Euro-Atlantike e Reagimit të Fatkeqësive të NATO-s (EADRCC) dhe u bë e mundur me kontribute financiare nga Republika Çeke, Lituania, Hollanda, Maqedonia e Veriut, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Kjo plotëson një dërgesë të mëparshme të 60 ventilatorëve në Ministrinë e Shëndetësisë për përdorim në katër spitale të dedikuara COVID-19 në Tiranë dhe rajone të tjera në vend. Kjo mbështetë vjen në përgjigje të kërkesave të Shqipërisë për ndihmë ndërkombëtare përmes Qendrës Koordinuese Euro-Atlantike



të Reagimit të Fatkeqësive në NATO. Pajisjet shtesë pritet të dorëzohen në Shqipëri në javët e ardhshme. NATO ka krijuar një rezervë të pajisjeve mjekësore dhe një Fond të Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike për të siguruar lehtësim të menjëhershëm të aleatëve ose partnerëve në nevojë. Agjencia e Ndihmës dhe Prokurimit e NATO-s

(NSPA) menaxhon blerjen dhe ruajtjen e sendeve të ndihmës.

Deri më sot, aleatët kanë miratuar nëntë paketa ndihme për katër aleatë: Shqipërinë, Republikën Çeke, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe për pesë partnerë, Bosnje dhe Hercegovinën, Irakun, Moldavinë, Tunizinë dhe Ukrainën.

PROCESI MËSIMOR



Akademia e Forcave të Armatosura, mësimi vazhdon online

Nga ana e stafit pedagogjik dhe atij mbështetës janë marrë të gjitha masat për vijimin e mësimin online me kurset institucionale që kanë vetëm pak ditë, që kanë filluar në AFA.

Pas prezantimit që ju bë programit mësimor sipas grupeve, nga ana e stafit mësimdhënës në ditën e parë të fillimit të kurseve, ditët në vazhdim ka vijuar procesi mësimor online. Aktualisht në procesin mësimor me KKSHP dhe KLO janë të angazhuar të gjitha departamentet dhe çdo gjë ka ecur normalisht dhe pa probleme.

PROJEKTI TEMATIK "TO BE READY"

Analiza për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021

Prioritetet kryesore të punës për 2021: Hartimin e statusit të AFA, ri akreditimi dhe përfshirja në konceptin e arsimimit profesional

Më datë 23.12.2020 në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarit Bunavi, u zhvillua analiza vjetore e Akademisë së Forcave të Armatosura, me pjesëmarrjen online të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Gjeneralmajor Bajram Begaj, drejtorëve të drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm. Analiza u drejtua nga komandanti i AFA Gjeneralbrigade Albert Mullai me prezencën e drejtuesve të institucioneve vartësisë. Në analizë u vlerësua puna e bërë si një aktivitet shumë intensiv për shkak të marrjes së statusit të veçantë, si institucioni i

vetëm i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, ndryshimit të strukturës organizative, hapjes pas 10 vite ndërprerje të programit bachelor. "Vijimi i punës për hartimin e statusit të AFA, ri akreditimin, përfshirja në konceptin e arsimimit profesional të problematikave lidhur me situatën e pandemisë Covid-19 do jenë prioritetet kryesore të punës për 2021. Bachelori do të jetë në fokusin kryesor të punës tonë", - theksoj në fjalën e tij gjeneral Mullai. Gjeneral Begaj vlerësoi punën e bërë nga i gjithë personeli i AFA, duke theksuar se keni mbështetjen time maksimale për vazhdimin e punës.



Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi"

Shpallet fituesi në pozicionin "Financier", ja detyrat e tij!

Financieri i projektit është përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit të projektit, përgatitjen e raporteve financiare, raportimin në sistemin eMS dhe menaxhimin e brendshëm të fondeve

Në kuadrin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire forecast and emergency management -355", me bashkëfinansim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", Ministria e Mbrojtjes ftoi kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin si më poshtë:

FINANCIER për zbatimin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire forecast and emergency management -355", bashkëfinansim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020". Në shpalljet e pozicionit vakant, dorëzuan dokumentacionin përkatës gjithsej 5 aplikantë për këtë pozicion, si më poshtë: Odetta Thomaj, Ilda Mile, Irma Vani, Lira Dheri dhe Gledis Bozo. Në përfundim të vlerësimit të dosjes personale të aplikantëve pjesëmarrës, testimin dhe intervistës së strukturuar, të zhvilluar më datën 28.12.2020, rezultoi se fitues i këtij pozicioni është shpallur znj. Lira Aleksandër Dheri.

Po cilat janë detyrat e financierit?

Financieri i projektit është përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit të projektit, përgatitjen e raporteve financiare, raportimin në sistemin eMS dhe menaxhimin e brendshëm të fondeve. Duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me Menaxherin e Projektit, Njësinë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, për të siguruar menaxhim eficient dhe të qëndrueshëm të financave të projektit. Financieri i Projektit do të menaxhojë llogarinë e projektit në bankën e nivelit të dytë dhe do të jetë firmë autorizuese për projektin në cilësinë e nëpunësit zbatues për projektin "TO BE READY"-Financieri i Projektit do të menaxhojë llogarinë e projektit, financat e tij, ndjekjen e realizimit të projektit dhe të kontratave, si dhe siguron një procedim normal për të gjitha procedurat e pagesave nën këtë projekt, përfshi menaxhimin dhe plotësimin e të gjitha llogarive speciale dhe të sigurojë që kërkesat e BE për të gjithë aktivitetet të realizohen.

Detyrat kryesore janë: Realizim një dokumentacion të plotë dhe sistemin e menaxhimit të operacioneve financiare, nëpërmjet llogarive të përshtatshme dhe kontrolleve të brendshme; përgatit



pasqyrat financiare dhe raportet që lidhen me aspektin financiar; përgatit planifikimin financiar/buxhetor afatshkurtër dhe afat-gjatë të projektit; siguron regjistrimin e saktë të transaksioneve të ndryshme. rishikon buxhetin e projektit sipas kërkesave të lindura; bën rishikimin financiar të performancës së aktiviteteve të projektit; siguron dhe mirëmban me saktësi dhe në kohë informacionin financiar; rishikon dhe aprovon të gjitha kërkesat për pagesat për aktivitetet e projektit; përgatit dhe rakordon deklaratat bankare; përgatit dhe administron dokumentacionin e nevojshëm të veprimeve financiare që do të ngarkohet në "elektronik Monitoring System"; përgatit raportin financiar dhe lista të hollësishme të shpenzimeve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Lider; përgatit dokumentacionin shoqëruar financiar përkatës, të kërkuar nga donatori, që i bashkëlidhet pagave të stafit të angazhuar në projekt. verifikon nga ana financiare Kohëshënuesit (time sheets) dhe orët e punës së stafit që i është dedi-

kuar projektit; mbikëqyr menaxhimin e llogarive të projektit dhe raporton tek Menaxheri i Projektit dhe Sektori i Financës të institucionit, për gjendjen e tyre; lehtëson punën e kontrollorëve nëpërmjet sigurimit të raporteve dhe dokumenteve të nevojshme financiare; bashkëpunon dhe ofron asistencë në terma të analizës financiare për raportet në "elektronik Monitoring System"; bashkëpunon dhe ofrim asistencë Njësisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve në AKMC dhe në Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me procedurat audituese për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA; pjesëmarrje aktive në aktivitete në kuadër të zbatimit të projektit; pjesëmarrja dhe angazhimi në grupe të ndryshme pune të krijuar me qëllim zbatimin e "TO BE READY"; detyra të tjera të ngarkuara brenda fushës së experiences, etj.

Por për realizimin e detyrave të mësipërme, ai duhet të ketë njohuri jo vetëm në fushën financiare por edhe një kulturë të gjërë ligjore sidomos: Ligjin Nr. 37/2015 "Për ratifikimin e

marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)"; Ligji nr. 138/2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020"; Ligji 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM Nr.541 datë 18.6.2015 Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimit IPA II (2014-2020). Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimit IPA II (2014-2020) faqja zyrtare e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, etj.

XHAÇKA: U ZHVENDOS NË POLIGONIN E BIZËS Gjetet bomba 500 kg nga Lufta e II-të Botërore në Tiranë

Gjetet një bombë e Luftës së Dytë Botërore në Tiranë, e cila është demoluar në mënyrë të kontrolluar nga Forcat e Armatosura. Lajmi bëhet i ditur nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, më 27 dhjetor 2020, e cila thekson se bomba peshon plot 500 kg dhe është gjetur në ish-fushën e aviacionit në kryeqytet.

"Forcat tona xheniere, të cilat pas pak javësh festojnë 100 vjetorin e krijimit, rikonfirmojnë se FA janë etalon i përkushtimit dhe profesionalizmit.

Një bombë me peshë 500 kg, e Luftës së II Botërore, u gjet në ish-fushën e aviacionit në kryeqytet dhe djemtë tanë të xhenios e zhvendosën në poligonin e Bizës, ku u demolua në mënyrë të kontrolluar dhe plotësisht të sigurt", - shkruan Xhaçka.



Qendra e Personel Rekrutimit

Vazhdojnë regjistrimet për ushtarë/detarë për periudhën 8 mars-14 maj 2021

Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri më 07 janar 2021

Qendra e Personel Rekrutimit vazhdon regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 08.03-14.05.2021, gjithsej 300 kandidatë, sipas rajoneve: Tiranë 145, Shkodër 20, Lezhë 4, Durrës 17, Vlorë 23, Berat 45, Elbasan 15, Burrel 7, Kukës 5, Fier 3, Gjirokastrë 3, Korçë 1, Poliçan 12 dhe sipas specialiteteve: Ndërlidhje 16, Këmbësori 104, MZ 5, Shofer 39, Mirëmbajtje 8, Kuzhinier 3, Xhenio 2, Infermieri 7, Roje 108, Muzikant 2, Përgjegjës kuverte 4, Municione. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në 07 janar 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve

Të jetë shtetas shqiptar. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të ketë figurë të pastër morale. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos ketë probleme me drogën dhe alkoolin. Të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme, apo kriminale. Moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç. Të ketë kryer arsimin parauniversitar, apo të lartë brenda, ose jashtë vendit. Të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak. Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

Procedura e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit. b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit



Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit. b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimin e përzgjedhjes, etj.

dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimin e përzgjedhjes, etj.

Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR

Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:

Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është: Kërkesë me

shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtarë/detarë aktiv, si dhe jo më pak se dy mundësi zgjedhje për njësinë, apo repartin në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formularin e aplikimit). Fotokopjen e kartës së identitetit. Certifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi. Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm. Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar të noterizuar

dhe certifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit, e noterizuar, ose të arsimit të lartë të noterizuar. Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njohje të gjuhës angleze, të noterizuara. Raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje infektive dhe të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale të jetës. Ekzaminimet mjekësore për agjentët infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv, si dhe formularët e vetëdeklarimit.

Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimin: Nëse kandidati shpallet fitues, brenda 2 (dy) javëve duhet të sjellë në QPR edhe dokumentacionin e mëposhtëm: Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga

Profesionet janë:
Ndërlidhje 16,
këmbësori 104,
MZ 5, shofer 39,
mirëmbajtje 8,
kuzhinier 3,
xhenio 2,
infermieri
7, roje 108, muzi-
Investimet në modernizimin dhe pajisimin e Armatës duhet të vazhdojnë. Një nga përparësitë e mia kryesore mbetet në vitet e ardhshme për të arritur qëllimin e caktuar, 2% e PBV-së të alokohet për mbrojtjen.” Informimi mbi gatishmërinë luftarake është një detyrim vjetor i planifikuar i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ndaj Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura.

NË KAZERMAT “ILINDEN”

Poligon i përbashkët i qitjes për forcat speciale

Bazuar në nevojën e forcave speciale të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore për të përdorur terrene specifike stërvitore dhe stërvitje, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë me forcat speciale nga Ministria e Brendshme që janë vendosur në kazemat “Ilinden” u iniciua një projekt i përbashkët për të trajnuar një poligon modern i qitjes për nevojat e këtyre njësisive.

Si rezultat i memorandumit të nënshkruar të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes si interes i përbashkët, në prani të ministres së Mbrojtjes Radmilla Sekerinska, ministri i Brendshëm Oliver Spasovski, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski u inagurua zyrtarisht poligoni i përbashkët i qitjes së forcave speciale të Ushtrisë dhe Ministrisë së Brendshme.

Poligoni i qitjes për pistoletë dhe mitraloz do të përdoret nga anëtarët e Task Forcës Speciale dhe njësitë



speciale të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore dhe është pjesë e poligonit luftarak urban në kazema.

Sipas nevojave dhe mundësive të

përcaktuara në vlerësimin balistik, poligoni i qitjes ka për qëllim kryerjen e guajtjeve përgatitore, instiktive dhe situative, si bazë për trajnimin e zjar-

rit të personelit të këtyre njësisive duke siguruar kushtet më të përafërta të një situatë reale luftarake.

Produkti përfundimtar i këtij projekti do të jetë rritja e cilësisë së trajnimit për qitje dhe trajnimi më i shpeshtë i stafit, i cili do të rrisë ndjeshëm nivelin e gatishmërisë, dhe do të kursejë kohë dhe burime për qitje që janë kryer në poligone të tjera.

Në të njëjtën kohë, poligoni i qitjes do të ketë një kapacitet, te destinuar për trajnim special në bashkëpunimin ndërkombëtar me vendet partnere dhe anëtarët e NATO-s. Në inagurim ishin anëtarë të Batalionit të Forcave Speciale të Ushtrisë, Task Forca Speciale e Ministrisë së Brendshme, të cilët zhvilluan tre stërvitje demonstruese të qitjes situative.



Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO ka një rëndësi të madhe, jo vetëm për atë vend, por edhe për sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Ajo shtoi se përbushja e detyrimeve nga agjenda e integritit evropian gjithashtu do të kontribuojë në përparimin e përgjithshëm të Maqedonisë Veriore dhe Malit të Zi, si dhe në forcimin e zhvillimit rajonal dhe stabilitetit.




Ministrja Olivera Injac-Ministrja Radmilla Shekerinska

Mali i Zi-Maqedonia Veriut: Bashkëpunimi në mbrojtje do intensifikohet

Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes kombëtare, në të njëjtën kohë kontribuon në përmirësimin e aftësive kolektive të Aleancës së Atlantikut të Veriut

Ministrja e Mbrojtjes e Malit të Zi, Olivera Injac, zhvilloi një takim online me ministrën e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë Veriore, Radmilla Shekerinska. Në fillim të takimit, ministrja Injac mirëpriti bashkëpunimin kuptimplotë dhe miqësor midis Ministrive të Mbrojtjes të të dy vendeve, si dhe Ushtrisë së Malit të Zi dhe Ushtrisë së Maqedonisë Veriore. Ajo veçanërisht theksoi rëndësinë e arsimimit të kadetëve malazezë në Akademinë Ushtarake “Gjenerali Mihailo Apostolski” në Shkup, si dhe veprimin e përbashkët në iniciativat rajonale, të cilat përfaqësojnë një platformë të shkëlqyeshme për forcimin e besimit të ndërsjellë. Ministrja Injac theksoi se anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO ka një rëndësi të madhe, jo vetëm për atë vend, por edhe për sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Ajo shtoi se përbushja e detyrimeve nga agjenda e integritit evropian gjithashtu do të kontribuojë në përparimin e përgjithshëm të Maqedonisë Veriore dhe Malit të Zi, si dhe në forcimin e zhvillimit rajonal dhe stabilitetit. Aleanca dhe bashkëpunimi midis dy vendeve brenda NATO-s paraqesin një kontribut veçanërisht të vlefshëm për sigurinë e përgjithshme rajonale.

Duke uruar homologen e saj malazeze për postin e saj ministror dhe zgjedhjen e një qeverie të re, ministrja Shekerinska nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit në rajon në fushën e mbrojtjes dhe rolin koheziv të NATO-s, ku të dy vendet janë anëtare të reja.



“Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi janë një shembull i bashkëpunimit të suksesshëm në arsimin e stafit të mbrojtjes dhe forcimin e aftësive të mbrojtjes. Mbështetja që morëm nga

Podgorica për hyrjen tonë në Aleancë ishte mbështetja për stabilizimin e të gjithë rajonit. “Përvojat tuaja nga anëtarësimi në NATO janë udhëzuesi ynë në procesin e integritit në sistemin

e NATO-s, për të cilin ne jemi mirënjohës”, - tha Shekerinska.

Ministrja theksoi se pranimit dhe funksionimi i Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi në NATO është një

tregues se nuk ka të mëdhenj apo të vegjël në Aleancë, por është një familje e vendeve të barabarta, me zë të barabartë dhe përgjegjësi të barabarta. Në këtë kuptim, Shekerinska nënvizoi se Maqedonia e Veriut po zhvillon Qendrën e saj Rajonale të Marrëdhënieve me Publikun për t'u rritur në një qendër për përballje me dezinformata lajme të rreme, me çka do t'i japin NATO-s dhe rajonit kapacitet shtesë për të luftuar ndikimet që duan të dëmtojnë stabilitetin dhe integritetin në Ballkanin Perëndimor. Takimi me video u përqendrua në shkëmbimin e pjesëmarrjes në stërvitjet e vitit të ardhshëm në Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, ku ministrja Shekerinska theksoi rëndësinë e poligonit ushtarak “Krivollak” dhe investimet e bëra nga Ministria e Mbrojtjes dhe Armata për të zhvilluar infrastrukturën e poligonit dhe për të rritur të kapacitetet e saj.

MINISTRJA OLIVERA INJAC-AMBASADORI I KROACISË, VESELKO GRUBISIC

Projektet dypalëshe do të vazhdojnë sipas dinamikës së planifikuar

Ministrja e Mbrojtjes Olivera Injac u takua me Ambasadorin e Republikës së Kroacisë në Malin e Zi, Veselko Grubisic. Gjatë takimit, ministri Injac dhe Ambasadori Grubisic shprehën kënaqësinë për marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe theksuan rëndësinë e forcimit të vazhdueshëm të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Ministrja Injac theksoi angazhimin e saj për zbatimin e përparësive të qeverisë së sapoformuar të Malit të Zi, veçanërisht në fushat e arritjes së qëllimeve të politikës së jashtme, si dhe për përbushjen me përgjegjësi të detyrimeve, që vijnë nga anëtarësimi në Aleancë. Ajo shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin në mbrojtje me Republikën e Kroacisë, duke theksuar vazhdimin e trajnimit të stafit në akademitë ushtarake kroate. Injac gjithashtu tha se nismat rajonale të mbrojtjes janë një



platformë e shkëlqyeshme për të konsideruar modalitetet e bashkëpunimit të përbashkët, të udhëhequr nga parimi i bashkimit të kapaciteteve dhe ndarjes së burimeve, dhe arriti në përfundimin se Mali i Zi dhe Kroacia kanë arritur rezultate të konsiderueshme dhe kanë ndërtuar besim duke vepruar së bashku në kontekstin rajonal të mbrojtjes.

Ambasadori Grubisic përgëzoj ministren Injac për emërimin e saj dhe i uroi asaj një mandat të suksesshëm. Ai

tha se Mali i Zi dhe Kroacia ushqejnë marrëdhënie të shkëlqyera aleate dhe se Republika e Kroacisë do të vazhdojë të mbështesë Malin e Zi në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Duke folur për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, ambasadori shprehu gatishmërinë për të vazhduar të gjitha projektet dypalëshe sipas dinamikës së planifikuar. Injac dhe Grubisic, shprehën gatishmërinë për një dialog të hapur politik për të gjitha çështjet me interes të përbashkët.




MINISTRJA OLIVERA INJAC

Sindikata është e mirëpritur në Ministrinë e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes Olivera Injac zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Sindikatës së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Malit të Zi. Me atë rast, ministrja Injac i tha delegacionit të SOVCG se ajo dëshironte të ndërtonte një dialog të hapur dhe produktiv për të identifikuar problemet dhe për të gjetur zgjidhje, në mënyrë që të kontribuonte në reformat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes. Delegacioni i SOVCG vuri në dukje mungesën e dialogut në periudhën e kaluar, si dhe mungesën e gatishmërisë për të punuar në tejkalimin e problemeve të mbetura në interes të përbashkët, në mënyrë që të realizohen më mirë qëllimet e përbashkëta. U theksua dëshira që SOVCG të jetë një partner besnik i Ministrisë së Mbrojtjes, në mënyrë që Ushtria e Malit të Zi të jetë në një institucion modern.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit ranë dakord për rëndësinë e kthimit të standardeve të larta etike në jetën e përditshme dhe punën në atë institucion. U konkludua se ekziston një synim i përbashkët për të filluar punë të përbashkët për përmirësimin e situatës së përgjithshme, për të mirën e të gjithë anëtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Malit të Zi.



“Unë jam jashtëzakonisht mirënjohës ndaj jush për detyrën ushtarake, profesionalizmin dhe përgjegjësinë që tregoni, për të cilën ju morët një vlerësim shumë të lartë nga udhëheqja e misionit në Afganistan”,- tha Shefi i Mbrojtjes Emil Eftimov.



SHEFI I MBROJTJES, ADMIRAL EMIL EFTIMOV

Bullgaria ka ambicie për zgjerimin e pjesëmarrjen në Kosovë

Ministri Krassimir Karakachanov dhe Admirali Emil Eftimov uruan ushtarët jashtë vendit për festat



Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov dhe Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov përgëzuan komandantët kombëtarë të kontingjenteve ushtarake bullgare, që marrin pjesë në operacione dhe misione në Afganistan, Gjeorgji, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Mali me rastin e festave të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri. Në konferencën video tradicionale, komandantët e njësive që kryejnë detyra në misionet dhe operacionet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian raportuan mbi gjendjen e kontingjenteve dhe zbatimin e misioneve dhe detyrave të tyre të caktuara. Nga raporti i komandantëve u bë e qartë se ushtarakët në misionet jashtë vendit festua Krishtlindjen dhe Vitit të Ri në përputhje me të gjitha masat anti-epidemike.

Komandanti i kontingjentit bullgar në Afganistan, Kolonel Todor Todorov, raportoi se situata në Afganistan mbetet e tensionuar, me aktivitet të lartë të grupeve rebele pavarësisht nga marrëveshja e arritur për bisedime paqësore midis qeverisë Afgane dhe Talibanëve. Kontingjenti Bullgar është zhvendosur dhe aktualisht po kryen detyra të sigurisë në Aeroportin Bagram. Koloneli Todorov theksoi se me gjithë vështirësitë, ushtarakët po përmbushin detyrat e tyre në misionin e NATO-s “Mbështetje të Vërtetë” me shpirt të lartë; sigurohen kushtet për komunikim me të afërmit në Bullgari. “Misioni juaj në Afganistan vazhdon të jetë më i vështiri. Ju uroj një mirëseardhje të mirë dhe pa incidente gjatë pushimeve”, -tha ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov. “Unë jam jashtëzakonisht mirënjohës ndaj jush për detyrën ushtarake, profesionalizmin dhe përgjegjësinë që tregoni, për të cilën ju morët një vlerësim shumë të lartë nga udhëheqja e misionit në Afganistan”,- tha Shefi i Mbrojtjes Emil Eftimov. Ai uroi që ushtarakët të ktheheshin të shëndetshëm dhe me forcë të plotë.

Komandanti i kontingjentit tonë në Bosnjë dhe Hercegovinë, i cili është pjesë e operacionit Altea të Bashkimit Evropian, kolonel Anastas Bakalov, raporton se situata e sigurisë është relativisht e qetë dhe e qëndrueshme, niveli i rrezikut është i ulët dhe nuk janë raportuar kërcënime. Sipas tij, ushtarakët festuan festat e Krishtlindjeve, në përputhje me të gjitha masat anti-epidemike. “Unë jam i lumtur të vë në dukje se sot janë ushtria që po kontribuon aktivisht në zbatimin e angazhimit të vendit tonë në Ballkanin Perëndimor. Prova e kësaj është rritja e kontributit tonë në Forcat Operative të Rezervës së Bashkimit Evropian dhe operacionet e NATO-s në zonën e përbashkët “Ballkan”,- tha admirali Eftimov.

Nënkolonel Petko Popovski, Ko-

mandant i kontingjentit tonë kombëtar në misionin e NATO-s në Kosovë, raporton se pjesëmarrësit në mision kanë pajisjet e nevojshme mbrojtëse personale dhe furnizimet e nevojshme për të kryer misionin e tyre në kushtet e Covid-19. Sipas tij, për momentin situata është e qëndrueshme, por ka kontradikta midis forcave politike në vend, të cilat mbartin rreziqe të

mundshme.

Ministri Karakachanov theksoi se Ushtria Bullgare ka një traditë të gjatë historike në territorin e Kosovës. Sipas tij, përqindja e ulët e të infektuarve në ushtarinë Bullgare tregon se ushtarakët janë të disiplinuar dhe të rreptë në vëzhgimin e masave anti-epidemike. Shefi i Mbrojtjes, Admiral Emil Eftimov, shtoi se Bullgaria ka ambicie për të

zgjeruar pjesëmarrjen e saj në misionin në Kosovë, për të cilin proceset përkatëse janë duke u zhvilluar në nivelin ushtarak dhe politik.

Toger Dr. Petko Ginev, komandanti i ekipit mjekësor të Forcave të Armatosura në misionin e BE-në për trajnimin e Forcave të Sigurisë të Malit, raporton se situata në vend është e qëndrueshme dhe nuk ka raporte të kërcënimeve ndaj kontingjentit bullgar. Ai theksoi se në kushtet e Covid-19 mjekët ushtarakë bullgarë përmbushi me sukses misionin e tyre dhe festat e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri janë kryer në përputhje me të gjitha masat anti-epidemike.

Komandanti i ushtrisë bullgare në misionin e vëzhgimit të BE në Gjeorgji, kolonel Georgi Margitin, raporton se vëzhguesit bullgarë po kryejnë me sukses detyrat e tyre në kushtet e Covid-19. Ata po marrin pjesë në patrullimin në vijën kufitare administrative të Gjeorgjisë me Abkhazinë, në zonën e përgjegjësisë së zyrave në terren “Gori”, “Mtsheta” dhe “Zugdidi”.

“Ju uroj më pak sfida në aktivitetet tuaja të përditshme në kohën e mbetur deri në kthimin tuaj në shtëpi. Përfaqësoni Bullgarinë dhe mbron aftësitë e ushtrisë Bullgare midis kolegëve tuaj në Gjeorgji”,- tha Admirali Eftimov. “Duke kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale, ushtarakët bullgarë kontribuojnë në krijimin e autoritetit të lartë që vendi ynë dhe Forcat tona të Armatosura kanë midis partnerëve të koalicionit në NATO dhe Bashkimin Evropian. Kjo u deklarua nga Komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkët, Gjenerallejtënant Lyubcho Todorov.

NË LUFTË KUNDËR EPIDEMISË COVID-19

“Shembulli më i mirë është dhënë me veprim”

Më 23 dhjetor, ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov dhe disa vullnetarë nga Akademia Mjekësore Ushtarake (MMA) morën pjesë në vijën e frontit në luftën kundër epidemisë COVID-19. Vladislav Lalov, Tsvetan Alexandrov, Konstantin Staev, Hristo Ivanov, Tsvetelina Dimitrova, Vladimir Karadzov, Maria Donkova, Miglena Tsakova, Angel Dzhambazki u vlerësuan nga Ministria e Mbrojtjes me një stimul nderi. Të gjithë vullnetarët janë të rinj. Me vetëmohim dhe përgjegjësi, për më shumë se një muaj, ata kanë punuar për të mbështetur ekipet mjekësore dhe pacientët duke pastruar dhe dezinfektuar, shpërndarë ushqim dhe ndihmuar në aktivitete të ndryshme. Ministri i përgëzoi fituesit për zgjedhjen e tyre të përgjegjshme për të mbështetur punën e mjekëve. Ai theksoi se duke iu përgjigjur thirrjes së MMA për vullnetarë, ata të gjithë e kanë përmbushur me dinjitet detyrën e tyre njerëzore dhe qytetare dhe kanë kontribuar në përpjekjet e përbashkëta për të kapërcyer epideminë. Ministri Karakachanov theksoi se me veprimet e tyre ata janë një shembull për çdo qytetar bullgar. “Shembulli më i mirë është dhënë me veprim”, - shtoi ministri i mbrojtjes.



Në kujtim të 13 ushtarëve që ranë për stabilizimin e Irakut

Në Plevën, në 23 dhjetor, u zhvillua një ceremoni përkujtimore në kujtim të ushtarakëve bullgarë të Brigadës së 5-të të Mekanizuar të Shipkës, të cilët vdiqën në misionin e Forcave të Koalicionit për Stabilizimin dhe Rindërtimin e Irakut. Koloneli Marin Gospodinov, Komandanti i Qendrës për Trajnimin Fillestar, tha se: “Njerëzit që rrezikojnë jetën e tyre jo vetëm duke mbrojtur integritetin territorial dhe kufijtë e vendit të tyre, por edhe duke shërbyer shumë përtej kufijve, meritojnë respekt dhe mirënjohje”,- theksoi koloneli Marin Gospodinov. Në operacionin për stabilizimin dhe rindërtimin e Irakut, Bullgaria humbi 13 ushtarë-Major Georgi Kachorin (vdiq më 27 dhjetor 2003), Toger i Lartë Nikolay Saraev (vdiq më 28 dhjetor 2003), kandidatët për oficerë Ivan Indzhov (vdiq më 27 dhjetor 2003), Anton Petrov (vdiq më 27 dhjetor 2003), Svilen Kirov (vdiq më 27 dhjetor 2003), Dimitar Dimitrov (vdiq më 23 prill 2004), Vladimir Pashov (vdiq më 24 tetor 2004), Gardi Gardev (vdiq më 4 mars 2005), Preslav Stoyanov (vdiq më 3 maj 2005), Valentin Donev (vdiq më 3 maj 2005), Marin Milev (vdiq më 21 qershor 2005), Tsvetan Kamov (vdiq më 14 qershor 2005) dhe Paun Georgiev (vdiq më 14 qershor 2005). Viti 2020 shënon 17 vjetorin e sulmit në qytetin Karbala, Irak.

Paqe në llogore, përralla më e bukur e Krishtlindjes

Pushkët mbetën në heshtje, pa e shqetësuar natën. Folëm, kënduam, qeshëm dhe për Krishtlindje luajtëm futboll së bashku, në baltën e tokës së askujt

Shumëkush e konsideron përrallën më të bukur të Krishtlindjeve, duke e krahasuar me një mrekulli. Në librat e historisë nuk ka pothuajse asnjë gjurmë, pavarësisht se flitet shumë nëpër filma dhe romane, madje edhe në një këngë folk të artistit anglez Mike Harding, të titulluar “Krishtlindjet 1941”.

Ja disa vargje: “Pushkët mbetën në heshtje [...] pa e shqetësuar natën. Folëm, kënduam, qeshëm [...] dhe për Krishtlindje luajtëm futboll së bashku, në baltën e tokës së askujt”. Ndeshja në fjalë u zhvillua realisht, dhe u luajt në 25 dhjetor 1924 pranë qytetit belg Ypres. Fusha e lojës: no man’s land (toka e askujt), hapësira që ndante llogoret angleze nga ato gjermane. Ishte momenti kulmor i asaj që në histori do të hynte si “paqja e Krishtlindjeve”.

Në verën e vitit 1914, Evropa ishte shndërruar në teatër të një lufte që shihte përballë dy aleanca të mëdha: Britania e Madhe, Franca dhe Rusia nga njëra anë; Gjermania, Austro-Hungaria dhe Turqia nga ana tjetër. Më vonë do të hynin në konflikt edhe Bullgaria, Japonia, Italia, Shtetet e Bashkuara si dhe një seri vendesh “të vegjël”, duke e transformuar kështu luftën në shkallë globale.

Në fillim, fronti më i nxehtë ishte pikërisht ai perëndimor (mes Belgjikës dhe veriut të Francës) ku anglezët, francezët dhe belgët duhej të pengonin përparimin e gjermanëve. Pas një beteje të përgjakshme pranë Ypres, në fund të vjeshtës ushtritë u gjendën të mbërthyer në një luftë që luftohej e gjitha përreth llogoreve. Nga këta hendeqe të thellë disa metra dhe të përforcuar me tryeza prej druri, ushtarët hidheshin përditë në sulm kundër armikut, duke fituar dhe lëshuar çdo herë disa pak metra terren dhe duke e kaluar pjesën tjetër të ditës mes baltës, shiut dhe kufomave që dekompozoheshin. Këto kushte ishin për të gjithë dhe “e keqja e përbashkët” provokoi shumë shpejt episode solidariteti mes armiqve (që ndodheshin vetëm disa metra larg nga njëri-tjetri). Ushtarët e dy ushtrive nisën të shkëmbejnë disa “ndere”, si përshembull mos hapja zjarr gjatë vakteve të ngrënies. Ajo që kish rëndësi ishte të ruhej aparenca me eprorët (rrezikohej të akuzoheshin për tradhëti) dhe kthimi shëndoshë e mirë në shtëpi.

Ulen armët!

Detyra e ndëshkimit të ushtarëve, që ishin treguar shumë të pajtueshëm me armiqtë u takonte zyrtarëve të komandës, të vetmit që mundeshin të vendosnin një armëpushim. Megjithatë, një rregull i tillë në Ypres dhe në zona të tjera të frontit u shkel në dhjetorin e 1914.

Pasi u kishin dhënë urdhër trupave, që të mos ndërprisnin për asnjë arsye luftimet, komandat e dy ushtrive dërguan në vijat e para të frontit pako të vogla dhuratash ku kishte ëmbëlsira, pije, duhan, pemë të vogla Krishtlindjesh dhe qirinj. Në Ypres, mbrëmjen e Krishtlindjeve gjermanët braktisën pozicionet duke shkëmbyer urime; në ndonjë llogore dikush këndonte Stille Nacht, Silent Night për anglezët. Që nga ai moment, e në një pjesë të mirë të mbrëmjes ushtarët e të dy ushtrive nuk pushuan së kënduari, secili në gjuhën e vet dhe secili në pozicionin e vet. “Kur zbukuruaam pemët dhe kur ndezhim qirinjtë, nga ana tjetër dëgjuaam fërshtëllima gëzimi dhe duartrokitje [...] Më pas kënduam të gjithë bashkë”, - dëshmonte pas luftës ushtari gjerman Kurt Zemich, në librin



“Natë e heshtur: Historia e armëpushimit të Krishtlindjeve në Luftën e Parë” me autor historianin Stenli Uaintraub, i cili e rindërtoi këtë ngjarje në vitet tetëdhjetë. Në momentin që shkuan të flenë pak, të gjithë ishin të bindur se po ndodhte diçka e jashtëzakonshme: në fakt, në mëngjes gjermanët nxorën kartonë të vegjël ku kishin shkruar “Gëzuar Krishtlindjet” dhe “Mos qëlloni, ne nuk do të qëllojmë”, ishte sinjali i fillimit.

Në fushë

Rifilluan këngët dhe duartrokitjet, më pas nga llogorja gjermane doli një burrë: në mes të mjegullës anglezët mezi e dallonin, ndonëse mjaftonte për të kuptuar se nuk ishte i armatosur. Britanikët, të shkujdesur dolën nga pozicionet dhe ecën drejt gjermanëve, që bënë të njëjtën gjë. “Pashë gjënë më të jashtëzakonshme: për pak sa po e qëllonim atë gjermanin, dhe pas pak ishim të gjithë në festë”, - shkruante ushtari anglez Dagën Carter në një letër drejtuar familjes.

Pasi varrosën trupat e të rënëve në ditët e fundit, të dy grupet u vëllazëruan, duke përgatitur një festë sipas të gjithë rregullave. “Fritz solli cigare dhe konjak, Tomi solli mish viçi dhe cigare”, këndon Mike Harding në këngën e tij. Pa sajuar asgjë: në ditarin e kampit të regjimentit 133 sakson flitet në fakt për një gjerman me emrin Fritz dhe gjithashtu edhe për Tommy, një ushtar anglez i cili u ofrua t’u priste flokët armiqve në këmbim të cigareve. Përreth tij të gjithë shkëmbejnë përfaqime dhe vizita kortezie. Anglezë dhe gjermanë dhuronin njëri tjetrit kafe dhe çokolata, marmelatë dhe cigare, çaj dhe uiski. Kishte madje nga ata që bënë fotografi në grup. “Nuk pati as edhe një moment të vetëm urrejtie: për një çast askush nuk mendoi për luftën”, - thoshte ushtari britanik Brus Bairnsfather, pothuajse si një skenë filmi.

Në fushë

Përpara se të ndërhyjnë komandat e larta për të ndaluar armëpushimin, ushtarët bënë një pakt solemn: në rast të rifillimit të luftimeve, askush nuk do të shënjestronte në gjatësinë e njeriut, por do të bënin josulmuese municionet duke “qëlluar yjet lart në qiell”. Ndërkohë, lajmi për armëpushimin u përhap, dhe brenda pak orëve ethet e armëpushimit pushtuan dy të tretat e frontit të perëndimit: pothuajse kudo anglezë dhe gjermanë shtrënguan duart dhe festuan së bashku.

Simboli i asaj Krishtlindjeve të pazakontë lufte u bë ndeshja e futbollit që u zhvillua në Ypres mes trupave angleze të regjimentit kocez dhe atyre gjermane të regjimentit sakson (por atë ditë në të vërtetë pati më shumë se një ndeshje futbollit). Topat u bënë duke bashkuar copa me qese plot me rërë të lidhura me spango, ndërkohë që portat u sajuan me pirge kapotash: për pak orë, “toka e askujt” u transformua në një fushë futbollit. Në ditët që pasuan, familjarët e ushtarëve u mbushën me letra dhe foto të kësaj ngjarjeje, që përfunduan në të përditshmet e asaj kohe. Shtypi (që i nënshtrohej censurës) e vonoi megjithatë botimin e lajmeve të parë të cilat gjithsesi dolën vetëm tek Nju Jork Taims. Në atë pikë u zgjua edhe shtypi evropian, dhe në 1 janar të vitit 1915 londinezja Tajms botoi një artikull për atë ndeshje, duke treguar edhe rezultatin përfundimtar: 3 me 2 për gjermanët. Lajmet mbi armëpushimin filluan të gjejnë ndërkohë gjithnjë e më shumë hapësirë në gazetat e Evropës veriore, me tituj euforikë dhe prekës si: “E jashtëzakonshme: gjermanë dhe anglezë shtrëngojnë duart”.

Sipari

Në disa raste armëpushimi zgjati deri për Vitin e Ri, por pothuajse kudo gjithçka përfundoi po në mbrëmjen e

Krishtlindjeve. “U përshëndetëm dhe rihymë në llogore [...] pastaj dëgjuaam të shtëna [...]: lufta kishte rifilluar”, -do të kujtonte me melankoli kapiteni anglez J. C. Dan. Por komandat e larta të të dy ushtrive nuk patën pikë nostalgjie nga ajo ngjarje. Iu futën menjëherë punës për të mos lejuar që të përsëriteshin raste të tjerë armëpushimesh skandalozë: nisën kërcënimet me dalje para gjyqit ushtarak për këdo që do të kishte kontakte me armikun, madje u fol edhe për idenë e bombardimit të llogoreve në ditët përpara Krishtlindjeve. Veç kësaj, për të mos lejuar që ushtarët të familjarizoheshin me armikun, u vendos që të zhvendoseshin me turne në zona të ndryshme të frontit. Filloi edhe një operacion censure për çdo lajm që kishte të bënte me armëpushimin e 1914, madje shkuan deri aty sa të mohonin zyrtarisht që kjo gjë të kishte ndodhur.

E gjithë kjo nuk mjaftoi për të penguar “binjakëzime” në të ardhmen. Por fryma e asaj Krishtlindjeve të parë lufte nuk pati kurrë më të barabartë. E ripërmbledhin këtë kujtimet e ushtarit anglez Xhorxh Id: “Një gjerman më pëshpëriti me zërin që i dridhej: sot kishim paqen, por nesër ti do të luftosh për vendin tënd dhe unë për vendin tim. Paç fat”. Më pas, në heshtje, u kthye dhe shkoi në anën tjetër. Mrekullia kish marrë fund.

Masakra

Në vitin 1915 lufta rifilloi më e ashpër se kurrë. Dhe në vitet që pasuan Ypres do të bëhej qytet i famshëm për bombardimet me armë kimike, që përfshinë edhe popullatën (qyteti i dha emrin njërit prej gazrave të përdorur, ipritit). Rikthimin në normalitetin e luftës trupave britanike ua shpalli një komunikatë e thatë: “Nuk ka më armëpushime, përfshirë edhe ndeshje futbollit... Në luftë nuk duhet të ndaloni asnjëherë vrasjen e armikut”. Dhe kështu, në pak muaj, ajo histori

e bukur Krishtlindjesh u zhyt në harresë. Jo të gjithë e morën keq: një ushtar me origjinë austriake, në atë epokë me shërbim pikërisht në zonën e Ypres, ishte shumë i kënaqur që të rifillonte të shtinte me armë, duke kritikuar dhunshëm atë “armëpushim idiot”. Quhej Adolf Hitler.

I kundërt në mendim qëndroi gjithmonë Berti Felstid, një zotëri anglez që vdiq në 22 korrik të vitit 2001, në moshën 106 vjeçare. Berti ishte i fundit që kishte mbetur gjallë e që kish marrë pjesë në një ndeshje futbollit të luajtur në një ditë speciale Krishtlindjesh: më pak e famshmjia, por ndoshta më e jashtëzakonshmjia e historisë.

Pauzë festive

Raste të vëllazërimit me armikun, në frontin italian u sinjalizuan në 25 dhjetor të 1916. “Armëpushimet” italiane konsistonin vetëm në lënien mënjanë të armëve, por në disa raste italianë dhe austro-hungarezë ngrinin dolli duke u ulur madje edhe gjunjë më gjunjë: për shembull në malet Kobilek (friuli) dhe Zebio (në zonën e sipërme të Asiagos). Nga kjo pauzë përfitoi edhe poeti Xhuzepe Ungareti, i cili pikërisht atë ditë shkruajti poezinë me emrin Krishtlindje.

Marrëveshje. Edhe jashtë periudhave festive ndodhte që mes italianëve dhe austriakëve të shkëmbeheshin ushqime dhe cigare, apo që të vendoseshin turne për përdorimin e një burimi uji. Në shkurt të vitit 1916, në malet e Karsos pati një armëpushim spontan të propozuar nga austriakët nën thirrjet “Ejani, nuk qëllojmë”. Dhe në maj të vitit 1917 në majën e Chapot (Friuli) disa oficerë kapën në befasi një grup alpinësh që kishin ndërmend të flisnin, të pinin e të tymosnin në shoqërinë e armikut.

Ishte 24 vjeç kur shkoi në misionin e saj të parë

Sabiha Gökçen, pilotja e parë, që mori pjesë në operacione ushtarake

Gökçen lindi në vitin 1913 në Bursa, një qytet në Turqinë veriperëndimore kur të huajt kishin pushtuar vendin. Ajo humbi babanë e saj, i cili ishte një ushtar, kur ishte shtatë vjeç dhe nënën e saj kur ishte 12 vjeç. Ajo ishte rritur duke parë vështirësitë e rënda të luftës. Një nga dëshirat e saj më të mëdha ishte, që të shkollohej. Gjatë një vizite nga Presidenti i parë i Turqisë Mustafa Kemal Pasha në Bursa, ajo iu afrua me guxim, duke shprehur interesin e saj për të studiuar. Pasha, i cili gjithashtu u bë i njohur si Ataturk, babai i të gjithë turqve, ishte aq i impresionuar nga pasioni i saj sa që e adoptoi Gökçen. Mendimi progresiv i Ataturk revolucionarizoi Turqinë. Ai besonte fort se e ardhmja e botës është në qiell dhe aviacioni është i një rëndësie të madhe. Ai ishte gjithashtu një besimtar i vendosur në faktin se edhe gratë mund të bëjnë gjithçka, që mund ta bëjnë burrat. U dha grave të drejtën e votës në 1934, si dhe të drejtën e divorcit.

Në 1935, Ataturk filloi Lidhjen Turke të Aviacionit, një nga organizatat e para joqeveritare të aviacionit në botë. Menjëherë pas kësaj, ai nisi Turkish Bird, një program trajnimiti fluturimi për individë të rinj turq. Ky ishte dhe fillimi ku Gökçen kuptoi, se ajo ishte magjepsur nga avionët. “Deri atëherë, kisha parë parashuta vetëm në filma. Unë kurrë nuk kisha parë ndonjë aeroplan të vërtetë në jetën time dhe as që mendoja të fluturoja”, - është shprehur ajo në një dokumentar të quajtur Sabiha Gökçen, Vajza Legjendare e Qiejve. Shumë shpejt ajo u bë studentja e parë femër e shkollës, ishte e vetmja femër në mesin e shtatë studentëve meshkuj, që udhëtoi në Bashkimin Sovjetik për trajnim shtesë në pilotimin e avionëve pa motor dhe atyre me motor përpara se të vendoste të bëhej një pilote luftarake në moshën 24 vjeçare. Në mars të vitit 1937, ajo u thirr për të luftuar në një revoltë kurde në Dersim. Vendosmëria dhe guximi i saj për kryerjen e zbulimeve të rrezikshme në detyrat e bombardimeve në operacionet ushtarake i dhanë asaj një vlerësim të madh. Ajo fluturoi me aeroplanë luftarakë në zonat e luftës dhe hodhi bomba në kampet e rebelëve. Në vitin 1937, Sabiha Gökçen u bë femra e parë në botë, që mori pjesë në një operacion ushtarak kombëtar, i cili drejtohej nga Turqia.

Kjo ishte në një kohë kur gratë në Shtetet e Bashkuara nuk lejoheshin të shërbenin si pilotë avionësh. Vetëm vite më vonë gratë mundën të bënin atë që Gökçen mundi. Në 1993, Jeannie Leavitt u bë pilotja e parë femër luftarake në Shtetet e Bashkuara. Në Indi, Gunjan Saxena u bë pilotja e parë luftarake që fluturoi në një zonë lufte gjatë Luftës së Kargil në 1999.

Gökçen fluturoi 8,000 orë dhe pilotoi 22 lloje të ndryshme të aeroplanëve gjatë karrierës së saj, nga të cilat 32 orë ishin në fluturime luftarake. Për nder të saj, aeroporti i dytë ndërkombëtar i Stambollit u quajt Aeroporti Ndërkombëtar Sabiha Gökçen në 2001. Dashuria e saj për avionët nuk vdiq kurrë. Ajo realizoi fluturimin e saj të fundit në moshën 83 vjeçare, me një aeroplan Falcon 2000 e shoqëruar nga një pilot francez, para se të vdiste në moshën 88 vjeçare.



Pilotja turke Sabina Gökçen Gökçen lindi në vitin 1913 në Bursa, fluturoi 8,000 orë dhe pilotoi 22 lloje të ndryshme të aeroplanëve gjatë karrierës së saj, nga të cilat 32 orë ishin në fluturime luftarake. Për nder të saj, në vitin 2001, aeroporti i dytë ndërkombëtar i Stambollit u quajt Aeroporti Ndërkombëtar Sabiha Gökçen.



Germania është prodhuesi kryesor i ushtarëve të Krishtlindjes ndryshe arëthyesve tradicionalë. Edhe pse kanë ekzistuar për shumë kohë, kukullat prej druri u bënë të njohura në SHBA në vitet 1950. Ushtari i Krishtlindjes fitoi emrin e tij nga kultura popullore gjermane dhe më pas u globalizua.

Friedrich Wilhelm Fuchtnier një drugdhendës i thjeshtë u bë krijuesi i tyre, frymëzuar nga versioni i historisë së Heinrich Hoffmann (shkrimtari i përrallës për fëmijë, “King Nutcracker or The Dream of Poor Reinhold” më 1851) krijoi modelin tradicional të ushtarit të Krishtlindjes, në vitin 1870, i cili më vonë hyri në prodhim seri, kjo është arsyeja pse ai u bë i njohur si “babai i arrëthyesit”. Biznesi familjar në Seiffen tani po drejtohet nga brezi i tetë i Fuchtnier. Jacob Grimm, më i madhi i vëllezërve të famshëm Grimm në traktatin e tij mbi mitologjinë gjermane, “Deutsche Mythologie” 1835 përshkroi se si gdhendeshin ushtarët e Krishtlindjes. Ata ishin prej druri të njohur si figura të forcës, që simbolizojnë fatin e mirë. Ata duhet të mbrojnë shtëpitë duke larguar shpirtrat e këqij.

Brezat e ushtarëve

Prodhimi masiv i kukullës prej druri filloi në fund të shekullit të 19-të, dhe prej atëherë nuk është ndalur. Kolorësi zviceran në anën e majtë daton rreth vitit 1650; pranë tij është një model

USHTARI I KRISHTLINDJES

Gjermania është prodhuesi kryesor i ushtarëve të Krishtlindjes



më i ri, që përshkruan një ushtar amerikan, ndërsa në të djathtë është një nga figurat e para tipike të rajonit malor Ore nga 1870.

Suvenire tradicionale dhe moderne

Prodhuesi më i madh gjerman i ushtarëve të Krishtlindjes tradicionalë është Steinbach. Pas Luftës së Dytë Botërore, biznesi familjar u rrit

shpejt duke mbajtur kontakte me ushtarë amerikanë të vendosur në zonën e Hanoverit të cilët u sollën familjeve të tyre ushtarin e Krishtlindjes si suvenir origjinal gjerman. Kompania krijon modele të reja të koleksionueshme çdo vit. Duhet gati 130 procedura të ndryshme prodhimi për të krijuar një ushtar Krishtlindjes të punuar me dorë. Secili prej tyre ka deri në 60 pjesë të cilat janë bërë prej bredhit dhe drurit të ahut.



FESTAT E FUNDVITIT NË FA

Fëmijët e ushtarakëve sjellin surprizë një "Musical"

Pandemia nuk i ka ndalur fëmijët e ushtarakëve të presin bukur festat e fundvitit. Ashtu siç është tashmë traditë edhe këtë vit Sektori i Aktiviteteve, pranë Qendrës, Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, ka sjellë në ditët e fundit të muajit dhjetor 2020 një koncert për bashkëmoshatarët e tyre. Nën drejtimin e specialistit të sektorit të aktiviteteve, regjizorit Saimir Braho, fëmijët e ushtarakëve zhvilluan një "Musical" pranë ambientit të Muzeut të FA. Përmes vargjeve, tingujve e kërcënimit, fëmijët kanë sjellë një atmosferë të gëzueshme në këto ditë të vështira për të gjithë botën, me shpresën se një vit më i mirë na pret në 2021. Ishin të pranishëm shumë fëmijë të ushtarakëve, prindër, Drejtorja Qendrës, Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, znj. Mirela Roshi, nën kujdesin e të cilës u zhvillua ky aktivitet etj.

